



E martë  
14 janar 2020

Viti XVIII  
nr 163

Çmimi  
30 L / 1 euro

E pavarur,  
periodike

www.shqiperia-etnike.com  
shqiperia\_etnike@yahoo.com

English, page 15

Drejtor  
Sokol Pepushaj



**Spartak Ngjela:  
ILIR META MË  
I RREZIKUARI  
NGA SPAK...**  
faqe 3



**JA  
POLITIKANËT  
QË KANË  
PASURI...**  
Sokol Pepushaj  
faqe 6



**PROVA E NJË  
MARRËV-  
ESHJEJE TË  
FSHEHTË...**  
Andi Bushati  
faqe 7

**Të gjithë  
shqiptarët  
kërkojnë  
ndryshimin  
e sistemit  
zgjedhor...**

Bashkëkryetarja e Komisionit për Reformën Zgjedhore në Kuvendin e Shqipërisë, Rudina Hajdari dhe deputeti Ralf Gjoni, në një konferencë për mediat, kanë folur mbi draftin për ndryshimin e sistemit zgjedhor, përfshirë edhe rekomandimet e organizatave të shoqërisë civile.

Gjatë fjalës së saj, deputetja Hajdari tha se nuk ka ndodhur asnjëherë në Kuvendin e Shqipërisë ku të ketë një platformë, ku shoqëria civile të vijë e të flasë dhe të shprehë mendimin e saj... / faqe 4

**Mesazhi  
i qartë i  
Holandës: Me  
Edi Ramën  
negociatat nuk  
hapen as në  
2020, mbron  
korrupsionin**

Edi Rama mashtroi shqiptarët duket festuar çeljen e negociatave në vitin 2018, por negociatat nuk do të hapen as në vitin 2020, për shkak të pesëfishimit të korrupsionit qeveritar gjatë gjashtë viteve të fundit... / faqe 8

## Yuri Kim betohet si Ambasadore e SHBA në Shqipëri: Do të zbatohen plotësisht reformat e do të ketë anëtarësim të shpejtë në BE



**“Mashtresesi” Rama, u tërhoq nga gjyqi me “Bild”; avokati gjerman Prinz, i kërkon 350 mijë euro detyrim kontrate që i merr nga taksat**

Kryeministër që bën pazare e plane dhune, me policë e trafikantë për vjedhje votash/ Shumë shpejt, do dëgjoni, se tashmë që është kryesues i OSBE, Rama do tërhiqet si “kërmidh” dhe nga gjyqet e kërcënimeve kundër mediave në Shqipëri; duke bërë sikur do luftojë për të garantuar lirinë e mediave në Bosnje Kazakistan, Kirgistan, Taxhikistan, Turkmenistan, Ukrainë e Rusi; ku patjetër do t'i kujtojnë e përplasnin në fytyrë, ligjin anti-media “Pinoçet” që ka hartuar në Shqipëri... f.5



# Yuri Kim betohet si Ambasadore e SHBA në Shqipëri: Do të zbatohen plotësisht reformat e do të ketë anëtarësim të shpejtë në BE

**Yuri Kim bëri para pak ditësh betimin si ambasadore e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri.**

Zonja Kim, u emërua nga Presidenti Donald Trump në qershor të këtij viti. Ajo ka thënë se do të nxisë udhëheqësit e Shqipërisë për të zgjidhur ngërçin aktual politik në mënyrë që të forcohet perspektiva e hapjes së negociatave të anëtarësimit në BE.

Zonja Kim ka thënë gjithashtu se do të inkurajojë Shqipërinë të zbatojë plotësisht reformat në drejtësi. Ajo është shprehur se sheh si përparësi edhe ndihmën teknike për Shqipërinë në hetimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar ndërnacional.

Zonja Kim pritet gjithashtu të inkurajojë Shqipërinë për të arritur nivelin 2 përqind në shpenzimet e mbrojtjes deri në vitin 2024.

Yuri Kim është gruaja e parë koreano-amerikane që përfaqëson SHBA në postin e një ambasadori dhe personi i parë nga territori amerikan i Guamit që shërben në një post të tillë.



Ajo ka lindur në Kore dhe është rritur në ishullin Guam, një territor i SHBA në Oqeanin Paqësor.

Ajo ka shërbyer në Departamentin e

Shtetit si Drejtore e Zyrës së Çështjeve të Evropës Jugore, ka qenë drejtore e Qendrës së Departamentit të Shtetit për Studimin e Diplomacisë, Shefe e

Stafit për Zëvendëssekretarin e Shtetit dhe Drejtore e Zyrës për Sigurinë Evropiane dhe Çështjeve Politiko-Ushtarake.

## Përndiqen nga prindi që i do murgjër, drama e tre të rinjve që nuk i pranon familja

Mohohen nga prindërit sepse nuk ju nënështruan babait të tyre për tu bërë murgjër. Jo vetëm kaq, por vuajnë edhe hakmarrjen e të atit kur janë rikthyer pas disa ditësh në Shqipëri pas deportimit nga Irlanda, atje ku janë përpjekur të ndërtojnë jetën e tyre sa më larg kërcënimit të babait që nuk u ndahet.

Historia e pazakontë lidhet me dy vëllezërit Kosta dhe Niko Dinkallari, dhe motrën e tyre Nertila Dinkallari. Nga shkak i një marrëveshjeje që prindi i tyre i detyruar nga arsye ekonomike kishte bërë me një prift, dy vëllezërit duhej të mbylleshin në një manastir për tu bërë murgjër. Nuk

mjaftoi ky konflikt midis dy vëllezërve dhe babait të tyre, por ndërkaq edhe motra, Nertila Dinkallari krijoi një lidhje sentimentale me një djalë, me të cilin mbeti pas disa muajsh shtatzënë. Vëllezërit Dinkallari tregojnë se kjo rrjedhë e papritur në familje i acaroi edhe më shumë mardhëniet mes prindërve dhe fëmijëve. Si të mos mjaftonte refuzimi i dy vëllezërve për tu mbyllur në manastir, edhe motra e tyre nisi bashkëjetesë me një të ri që i përket një besimi të ndryshëm fetar. Kjo ishte edhe më e pa pranueshme për prindin e tre fëmijëve, i cili nisi ti trajtojë dhunshëm. Kur jetesa në familjen e tyre në fshatin Porodinë të Korçës

ju bë e padurueshme, vëllezërit Dinkallari njëri pas tjetrit, si dhe Smotra e tyre u detyruan të emigrojnë.

Ata kanë mundur të vendosen për pak ditë në Irlandë, por nga fundi i vitit të kaluar dy vëllezërit u deportuan. Ky fat u erdhi për shkak se shteti irlandez nuk ka marrë parasysh historinë e tyre të dhimbshme.

Si të mos mjaftonte kjo dramë, dy vëllezërit Dinkallari kur u kthyen në vendlindje e provuan se hakmarrja e babait të tyre u ishte bërë si hije.

Të kërcënuar vazhdimisht me jetë dhe të frikësuar nga përndjekjet e fafesisit, dy vëllezërit zgjodhën të vendosen në Tiranë ku zunë një banesë me qira. Ata dëshmojnë se në ditët e para të janarit u sulmuan befasisht nga persona të maskuar. Kanë qënë tre njerëz të panjohur që dyshohet se janë shtyrë të hakmerren, ata që goditën me sende të forta dhe si pasojë lanë të dëmtuar më rëndë njërin prej vëllezërve. Niko Dinkallari u lëndua në pjesën e fytyrës, dhe si pasojë u trajtua në spitalin e traumës në Tiranë.

Ndërsa policia është vënë në kërkim të autorëve të ngjarjes, për dy



vëllezërit e ndarë përfundimisht nga konflikti me babain e tyre, siguria e jetës në Shqipëri rrezikohet.

Redaksia



# Spartak Ngjela: Ilir Meta më i rrezikuari nga SPAK, pas shkarkimit nga Parlamenti nuk do ketë asnjë rol, funksionet e tij do të pezullohen

Vendimi i mazhorancës për t'i shkuar deri në fund shkarkimit të Ilir Metës nga posti i presidentit dhe interpretimet e ndryshme të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, kanë sjellë një valë përplasjesh institucionale. Avokati Spartak Ngjela u shpreh ditën e djeshme se pas shkarkimit nga Parlamenti, Meta do të jetë i pezulluar dhe nuk do të ketë asnjë funksion deri sa të merret një vendim i formës së prerë nga Gjykata Kushtetuese, pasi kjo të jetë funksionale. Avokati më tej shprehet optimist se Kushtetuesja do e plotësojë kuorumin e vet shumë shpejt dhe brenda një kohe të shkurtër ajo do të jetë funksionale.

“Shenjat janë që Parlamenti do ta shkarkojë Metën, por çështja nuk mbaron aty, duhet të shkojë në Gjykatën Kushtetuese. Por kjo gjykatë është jashtë funksionit ende dhe është Ilir Meta ai që po e bllokton. Mazhoranca është e vendosur për shkarkimin e tij. Por ka edhe një formë juridike. Sipas kësaj forme e shkarkon një herë Parlamenti dhe pastaj ai ri “stande by” pa kompetencat e presidentit, i pezulluar deri sa të ngrihet Kushtetuesja. Juridikisht operohet kështu, e shkar-kon Parlamenti, por nuk shkarkohet pa shkuar në Gjykatën Kushtetuese për të marrë formën e prerë. Në rast se Kushtetuesja nuk është në formim ose në punë apo ka çështje shumë për të gjykuar, në këto momente që presidenti është i shkarkuar de facto ai qëndron i pezulluar derisa të ngrihet Gjykata Kushtetuese. Shenjat janë se kjo gjykatë mund të jetë shumë shpejt funksionale por pritet të shihet se çfarë procedure do të ndiqet”, u shpreh Ngjela për gazetën “SOT”.

Avokati më tej deklaroi se mazhoranca me ligjin e ri i ka hequr të gjitha kompetencat presidentit për betimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. “Ligji i ri që del këto ditë ia ka hequr kompetencat presidentit që gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të betohen te presidenti dhe në këtë mënyrë KLGJ mund të emërojë dy të tjerë. Nuk ka rëndësi farë nëse nuk i pranon presidenti pasi ata mund ta bëjnë betimin në mënyrë individuale nëpërmjet një noteri që konstaton firmën dhe ia çojnë zyrës së presidentit. Duke u nisur nga këto premisa, Gjykata Kushtetuese brenda një muaji do të plotësojë ku-



rumin e vet”, u shpreh Spartak Ngjela.

Hetimi nga SPAK

Por avokati në reagimin e tij për gazetën komentoi edhe ngritjen e Strukturës së Posaçme Antikorrupsion, ku theksoi se nga ky institucion janë të rrezikuar 4 liderët e vendit, ku ndër ta veçoi presidentin Ilir Meta. Sipas Ngjelës, mbi kreun e shtetit rëndojnë shumë akuza për të cilat duhet një hetim më i thelluar.

“Gjatë këtij viti do të fillojë një he-

tim i thelluar i zyrtarëve të lartë dhe nën hetim do jenë 4 liderët e vendit, Sali Berisha, Ilir Meta, Edi Rama dhe Lulzim Basha. Shenjat janë që më i rrezikuar është Meta sepse ka dhe shkeljet e rënda kushtetuese si president, por edhe dyshimet e mëdha për korrupsion. SPAK do t'i marrë nën hetim sepse është kërkesë kushtetuese dhe nuk mund të shkelet Kushtetuta. Pastaj se si do ecë hetimi dhe si do vazhdojë çështja e procedimit ajo va-

ret nga SPAK. Janë dy institucione kryesore, Gjykata e Posaçme dhe Prokuroria e Posaçme. Kjo e fundit do të ushtrojë hetimin. Këto kohë pritet të ngrihet edhe BKH që është pjesë e Prokurorisë së Posaçme. Të tre këto institucione do të merren me korrupsionin dhe krimin e organizuar, i cili është një gjëmë e madhe për Shqipërinë”, tha Ngjela.



# Mbi 50 mijë nënshkrime/ Nisma që sfidon njëkohësisht dhe Ramën dhe Bashën

Një përfaqësi e një grupimi të madh prej 50 mijë firmëtarësh që kanë nënshkruar për ndryshimin e sistemit zgjedhor, nga ai me lista të mbyllura ku për deputetët vendosin vetëm kryetarët në një proporcional kombëtar ku për të zgjedhurit në kuvend vendosin me votën e tyre vetë qytetarët ka dorëzuar sot në parlament një dokument të shkruar. Dy nga drejtuesit e Nisma Thurje, Pano Soko dhe Endri Shabani, i lanë në duar bashkëkryetares së komisionit për reformën zgjedhore, Rudina Hajdari (video poshtë), draftin që parashikon një demokratizim më të madh të parlamentit dhe për rjedhojë edhe të jetës së brendshme të partive, një vartësi më të reduktuar të të zgjedhurve të popullit nga liderët e partive, një çlirim të vendimmarrjes politike nga dy njerëz të vetëm, Edi Rama dhe Lulzim Basha.

Në thelb, propozimi parashikon një sistem elektoral të përafërt me atë të Kosovës, kur sejcila parti paraqit



në votime një listë kandidatësh dhe pastaj janë zgjedhësit që vendosin se cilin prej tyre do dërgojnë në parlament dhe cilin do të djegin.

Por, ndryshimi i sistemit që qëndron në këmbë që pas përmbysjes së kushtetutës brenda një nate, në prill 2008, ku Rama dhe Berisha u morën vesh sipas parimit: “O ta kesh ti, ose unë gjithë pushtetin”, ka hasur edhe

njëherë në kundërshtimin e dy kryetarëve të partive të mëdha.

Që në fillim Rama ka qenë kundër këtij versioni, duke u mbrojtur pas justifikimit se njëherë duhen bërë sugjerimet që ka bërë OSBE- ODIHR.

Edhe Basha që në fillim e la një derë të hapur për ndryshimin e sistemit, i është kthyer qëndrimit rigjid nga frika se mos humbet kontrollin mbi partinë.

Fillimisht ish deputeti i PD, Sali Jani deklaroi në Zonë e Lirë se kreu i PD ishte pro listave të hapura. Por ditët e fundit, Monika Kryemadhi dhe Nard Ndoka konfirmuan se kjo ide kishte rënë e më pas Genc Pollo tha se ajo nuk e shmangte dot abuzimin me votën dhe vjedhjen e saj.

Në fakt, çfarëdo alibie që ka përdorur edhe PS edhe PD, nuk është aspak bindëse. Në thelb njësoj ato fshehin qëllimin që Rama dhe Basha të ruajnë kontrollin absolut mbi dy partitë respektive e për pasojë edhe mbi skenën politike në vend. Pikërisht për këtë, inisiativa e Nisma Thurje, ndonëse ka pak gjasa të realizohet në praktikë, ka vlerë për të treguar se sa të ngjashëm janë lideri i rilindjes dhe gjoja kundërshtari i tij, se sa e marrin ata për bazë vullnetin dhe vendimarrjen e qytetarëve, sa të vendosur janë për të penguar çdo lëvizje që gëlon jashtë kontrollit të tyre.

## Të gjithë shqiptarët kërkojnë ndryshimin e sistemit zgjedhor...

**Bashkëkryetarja e Komisionit për Reformën Zgjedhore në Kuvendin e Shqipërisë, Rudina Hajdari dhe deputeti Ralf Gjoni, në një konferencë për mediat, kanë folur mbi draftin për ndryshimin e sistemit zgjedhor, përfshirë edhe rekomandimet e organizatave të shoqërisë civile.**

Gjatë fjalës së saj, deputetja Hajdari tha se nuk ka ndodhur asnjëherë në Kuvendin e Shqipërisë ku të ketë një platformë, ku shoqëria civile të vijë e të flasë dhe të shprehë mendimin e saj.

“Projektligj është komplementar me disa propozime të tjera që kanë ardhur pranë Komisionit të Reformës Zgjedhore në lidhje me këtë çështje. Jam e kënaqur bashkë me deputetin Gjoni që i japim mundësi shoqërisë civile të vijë në Kuvendin e Shqipërisë, sepse Kuvendi është i shqiptarëve dhe jo i disa politikanëve. Nëse ne vërtetë një ditë do ta bëjmë ndryshimin, ne duhet t’ja rikthejmë parlamentin shq-

iptarëve”, tha Hajdari.

Sipas saj kjo nismë i hap rrugë forcimit të demokracisë në vend, forcimit të shtetit të së drejtës dhe forcimit të drejtësisë në Shqipëri, “për të pasur një parlament, i cili i rikthen forcën qytetarëve dhe jo pushtetarëve.”

Ndërsa deputeti Ralf Gjoni në fjalën e tij tha se ky draft ka të bëjë me hapësirat që duhen krijuar në Parlament për të përkthyer shtyllën e dytë të demokracisë shqiptare.

“Pas reformës në drejtësi, sfida kryesore e të gjithë shqiptarëve është ndryshimi rrënjësor i sistemit zgjedhor për t’i kthyer legjitimitetin institucionit bazë të një demokracie parlamentare që është Parlamenti”, tha Gjoni.

Sipas Gjoni, Shqipërisë i duhet sistem proporcional kombëtar me lista të hapura, “ku qytetari të zgjedhë deputetin që do.”

“Nuk është koha për parti të reja, e rëndësishme është që komisioni ta marrë në konsideratë këtë propozim që vjen nga shoqëria civile”, tha Gjoni.

Kujtojmë se sipas Kushtetutës së Shqipërisë, deputetët zgjidhen me sistem proporcional me zona zgjedhore shumëmemërore.

Kuvendi i Shqipërisë ka ngritur komisionin e posaçëm për reformën zgjedhore i cili ka për detyrë të hartojë ndryshime të kuadrit ligjor zgjedhor për trajtimin e plotë të rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODIHR-it, si dhe të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet./AA



# “Mashtruesi” Rama, u tërhoq nga gjyqi me “Bild”; avokati gjerman Prinz, i kërkon 350 mijë euro detyrim kontrate që i merr nga taksat

*Kryeministër që bën pazare e plane dhune, me policë e trafikantë për vjedhje votash/ Shumë shpejt, do dëgjoni, se tashmë që është kryesues i OSBE, Rama do tërhiqet si “kërmidh” dhe nga gjyqet e kërcënimit kundër mediave në Shqipëri; duke bërë sikur do luftojë për të garantuar lirinë e mediave në Bosnje Kazakistan, Kirgistan, Tashikistan, Turkmenistan, Ukrainë e Rusi; ku patjetër do t’i kujtojnë e përplasnin në fytyrë, ligjin anti-media “Pinoçet” që ka hartuar në Shqipëri*

Në Ministrinë e Financave, ka mbërritur një njoftim për shlyerje detyrim porosie shërbimi juridik nga Gjermania; dërgues i të cilës, është zyra e avokatit gjerman, Matthias Prinz; emër i bërë i njohur, nga kryeministri Rama, pas publikimit në “Bild”, të audio-përgjimeve të skeduar në “Dosja 184”, hapur për vjedhjen e votave nga grupi “Gjiknuri-Manja” në Dibër.

Pas publikimit të bisedave konkrete, kryeministri Rama e humbi kontrollin logjik dhe kërcënoi me dënim gjyqësor gazetarin e “Bild”, madje e bëri padinë penale ndaj tij; kur gazetari Peter Tiede, paralajmëroi se do publikonte regjistrime të tjera, edhe me fakte orgjie ministrash e deputetësh gjatë fushatës për vota në Dibër.



Në orën 14 e 55 minuta, të datës 25.06.2019, kryeministri Rama, njoftoi publikisht në FB, Twitter e ETRV, duke thënë me kapardisje kërcënuese: – “Sapo i kam dhënë prokurën avokatit gjerman Matthias Prinz, për nisjen e procesit gjyqësor mbi publikimet e “Bild”! Gjykatat gjermane, le ta vendosin kush ka të drejtë e kush ka faj në këtë mes...”

Kanë kaluar afro 7 muaj dhe as gazetari gjerman Tiede, i akuzuar për “shpifje”, nuk është njoftuar nga gjykatat gjermane për kallëzimin e bërë nga Edi Rama; por as kërcënuesi dhe denigruesi Rama, nuk e ka përmendur më, çështjen e gjyqit kundër “Bild”; ndërkohë që ka punuar të zh-

duk dosjen “Dibra-184”.

Mirëpo, këtë proces gjyqësor në Gjermani; nuk e paska harruar avokati gjerman Matthias Prinz; i cili po i kërkon Edi Ramës, pagesën e shërbimit të avokatisë “anti-Bild”, për punën e kryer deri në datën 20 shtator 2019, kur klienti i tij kryeministër i Shqipërisë, për arsye që i di vetë; kërkoi ta ndërpriste e tërhiqte shërbimin gjyqësor (kallëzimin); porositur me prokurë e kontratë të posaçme më 25.06.2019.

Pagesa e kërkuar, është 750 euro/për 1 orë shërbim avokatie nga zyra juridike e gjermanit Matthias Prinz; të cilat, të mbledhura së bashku, janë bërë 350 mijë euro orë/pune; deri në

orën, kur “trimi” Rama u tërhoq për “etike” e jo për... frikë.

Atëherë, Edi Rama, nuk dha sqarim për mediat e huaja e ato shqiptare; për pyetjen nëse pagesën e avokatit gjerman dhe fakturat e gjyqit, do t’i bënte nga xhepi i tij, apo nga buxheti i shtetit.

Por njoftim-fatura e dërguar në Ministrinë e Financave dhe jo në adresën “Sarajet e Surrelit”; tregon se edhe shpenzimet për gjyqin personal kundër “Bild” e të pa çuar deri në fund; nuk do t’i paguaj kryeministri, por nga taksat publike.

Pra, kryeministri Rama dhe banda e tij; vjedhin vota për të vjedhur pushtet; dhe vjedhin pushtet, për të vjedhur pasuri, ndërsa milionat e krimeve të tyre i paguajnë shqiptarët.

Ky nuk është rasti i vetëm, që për pazaret korruptive, egoizmat, interesat personale; dhe krimet e kryeministrit e të ministrave të bandës “Rilindja”, paguhen miliona euro gjoba, dëmshpërblime e shpenzime avokatësh dhe gjyqesh ndërkombëtare; ku rekord janë 16 milionë euro të pallatit të Lulzim Bashës në Vlorë e 110 milionë euro, të TV-së, që Rama e mbylli se i bënte konkurrencë “Klan”-it të Sandrit të PPP-së Milot-Balldren dhe “TOP”-it të Vjollcës së famshme.

## Të gjithë përplasen tek Dritan Dajti, të gjithë janë me Dritan Dajtin, por amerikanët po bëjnë drejtësi duke çuar në burg edhe gjyqtarë

Tre gjyqtarët që u kontrolluan fill pas shpalljes së vendimit për Dritan Dajtin, nën filmimet e bëra publike nga forcat speciale përplasen me njëra tjetrën, gjykatën e posaçme, SPAK dhe policinë e shtetit. Ndërsa Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar kundërshoi prokurorinë SPAK, që kërkoi pushim të hetimeve për gjyqtarët Aleks Nikolli, Petrit Aliajt dhe Skënder Daminit, SPAK pretendon se informacioni i është sjellë nga policia e shtetit në mënyrë jo procedurale.

“Informacionet e parashtruara nga oficerët e policisë gjyqësore në referimin penal si dhe në vijim gjatë hetimeve, përsa i përket elementëve penalë të parashikuara nga nenet 319 dhe 319c të kodit penal, janë informacione të mbledhura në rrugë gjurmuese poli-

core, nuk janë të dhëna që janë marrë në formën e duhur procedurale, si të tilla, të vetme, nuk mundet të shërbijnë si burim prove me vlerë provuese në këtë referim penal”. Por për çfarë informacioni bëhet fjalë për të cilin SPAK nuk mundi të provojë atë që policia gjyqësore i referoi bazuar në gjurmim? Siç pretendoi në atë kohë policia persona të caktuar mund të kishin influencuar tek gjyqtarët për të dhënë vendim favorizues për Dritan Dajtin, por pavarësisht kësaj si dhe zgjatjes dy herë të hetimeve, prokuroria nuk mundi të gjejë prova.

Prokurori i çështjes kërkoi kthim të sendeve personale të tre telefonave dhe të shumën prej 17 mijë euro që sipas prokurorit ishin të ardhura nga familjarët e gjyqtarit Skënder Damini. Por as prokuroria dhe as policia nuk kishin gjetur adresën e një të katërti

nën hetim, që konsiderohet avokat dhe që kryen shpesh takime me Dajtin. Ky është një nga shkaqet se përse gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar i konsideron hetimet të paplota dhe duhen vazhduar më tej. Edhe pse ndërkohë gjyqtarët

nga ana e tyre deklarojnë se kanë ushtruar detyrën. Pas heqjes së burgimit të përjetshëm dosja “Dajti” gjendet në gjykatën e lartë ku të dyja palët edhe prokuroria dhe avokatët kanë dorëzuar rekurs. /TCH/



# Ja politikanët shqiptarë që kanë pasuri, secili më shumë, se rroga e gjithë Presidentëve të SHBA në 243 vjet histori

**Fëmijët e Presidentit të Republikës Ilir Meta, prej shumë vitesh në Londër konsumojnë diçka më tepër se të ardhurat e Presidentit të SHBA, djali i ish-presidentit e ish-kryeministrit Sali Berisha, Shkëlzeni që shkëlqen si pasanik në Europë dhe më përtej, edhe këto vitet e fundit në opozitë, jo vetëm bën jetë luksi dhe nuk dimë t'i thotë dikush puna e mbarë, por shton në numrin e llogarisë kursime përrallore, sa tre herë rroga e Presidentit amerikan!**

## Nga: Sokol Pepushaj

Është interesante. Këtu në Shqipëri në post-komuniste në 28 vite çudirash, të tërë politikanët, pushtetarët, zyrtarët e lartë të shtetit më të varfër në botë janë milionerë. E përveç këtij paradoksi të paparë deri sot në Glob, këta kanë jetuar e jetojnë në luks fantazish të çmendura.

Pasuritë e trashëguara dihen, pasi është tepër e thjeshtë të përlllogariten resurset private në 28 mijë kilometër katror, ku dihet prodhimi e konsumi, dihet numri i popullsisë dhe numri i "pasanikëve" me çertifikatë trangu në vlera, për botën perëndimore zero me xhufkë, llogariten rrogat për zyrtarët e zabitët e pushteteve që nga Aleksandër Meksi e deri tek Edi Rama.

Të tërë erdhën nga hiçi, por sot çuditërisht kemi qindra budallenj e vagabondë pushteti që posedojnë pasuri secili sish, shumë herë më tepër se kursimet e tërë Presidentëve të Amerikës së bashku në 243 vjet histori.

Fëmijët e Presidentit të Republikës Ilir Meta, prej shumë vitesh në Londër konsumojnë diçka më tepër se të ardhurat e Presidentit të SHBA, djali i ish-presidentit e ish-kryeministrit Sali Berisha, Shkëlzeni që shkëlqen si pasanik në Europë dhe më përtej, edhe këto vitet e fundit në opozitë, jo vetëm bën jetë luksi dhe nuk dimë t'i thotë dikush puna e mbarë, por shton në numrin e llogarisë kursime përrallore, sa tre herë rroga e Presidentit amerikan!

Por çdonjëri politikan e pushtetar i ngjan tjetrit. Ai që presupozohet të vijë në pushtet, shefi i opozitës Lulzim Basha që shitet si Engjëll, në anën tjetër ka një çështje ku akuzohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për 230 milionë dollarë abuzime dhe vjehri i tij, një pensionist pa emër, 6 vjet më parë na rezultoi me një pallat 8 milionë dollarësh dhe pas rrëzimit të objektit nga kryeministri Rama e ankesës së tij, sheti detyrohet ta shpërblejë me 14 milionë dollarë. Pra, lojë pasanikësh e hajdutësh në dëm të ekonomisë së një populli që deri më sot ka qënë i detyruar ose të votojë njërin hajdut, ose tjetrin.

Po edhe vetë kryeministri Edi Rama është model unik në Glob për magji në shtim pasurie. Në vitin 2011 ai ka deklaruar me shkrim se është i pas-trehë dhe me 3000 euro kursime, por sot ka një pasuri të madhe në Surrel, të pajustificuar ende, i akuzohet bashkëshortja për disa miliarda dollarë aksione tek AbiBank, sërish ende pa përgjigje, vëlla Olsi, ish-emigrant për pak kohë si 1.500 000 shqiptarë të tjerë, i përfolur në shtyp për "fshehje" të mbi 200 milionë dollarëve në

nga veprimtaria për arrestimin e tyre dhe sekuestrimin e gjësë së vjedhur.

Por. Le t'u referohemi pak studimeve që bota njeh deri më sot për historikun e milionave. Një artikull në "visualcapitalist.com" publikon informacione se sa kohë u është dashur personave më të pasur të planetit që të arrijnë 6 zerot e para. Nëse analizojmë kampionin e tyre, mesatarisht do të duheshin 8 vite për të arritur milionin e parë. Dhe jo para moshës 36-vjeçare.

juesit e 6 zerove të para nuk jetojnë.

Sido qoftë, në këtë çorbën me milionerë shqiptarë që të tërë do sekuestrohen e dënohen, pasi në një treg pa prodhim fare, pa fuqi blerëse dhe konsum, nuk ka shanse milionerësh, duam t'ju kujtojmë fatzinjve se ata fatlumët e Globit që trashëguan miliona dollarë, pra super të pasurit, ndeshen me një treg jo të lehtë, ku një grupi, atyre të kokës, u duhet rreth 5 vjet të bëjnë 1 milionë dollarë shtesa, skuadronit të dytë të gjigandëve të Botës u duhet



parajsat fiskale, gjithashtu pa sqarime e justifikime.

Po kështu, milionerë janë të tërë, nga fundi në krye e kryet në fund. Çdo politikan, çdo pushtetar, çdo ministër, por edhe çdo "ushtar" që u ka qëndruar afër është milioner.

Pasuritë janë të dukshme, shihen ngado, por ata mendojnë se ende nuk ka fakte dhe se do t'ja hedhin organeve të drejtësisë të mbikqyrura rreptësisht nga Amerikanët.

Janë të gabuar dhe shumë të terrorizuar nga SPAK që është gati të nisë

Ky është fakt i gjallë për të pasurit e të diturit e Globit, por aspak i besuar për injorantët e fukarenjtë e Shqipërisë që u bënë milionerë të tërë pa përjashtim, sapo morën pak pushtet çfarëdo, qoftë edhe polic fshati.

Super të pasurit e kësaj Bote sot vlejnë rreth 744 miliardë dollarë dhe janë fiks 2153 të tillë. Gati të tërë këta persona e kanë trashëguar pjesërisht ose plotësisht pasurinë që kanë dhe në këto raste, për ata nuk është kërkuar se si e kanë bërë milionin e parë, pasi normalisht e kishin trashëgimi e kri-

mesatarisht 10 vjet dhe të suksesshme të tretë u janë dashur rreth 17 vite punë me fantazi efektive.

Këto janë shifrat e vërteta e kokëforta që njeh deri sot Bota, kjo është logjika ekonomike, por këta hajdutët e Shqipërisë së çudirave në 28 vite kanë vjedhur e i kanë vënë milionat si me magji, ndaj besimi i shqiptarëve te politika është i zbehtë, njëllonj si ekonomia e shumicës që vuan e pret përditë arrestimin e "Peshqve të Mëdhenj" dhe kthimin e gjësë së vjedhur që është marramëndëse!

# Prova e një marrëveshjeje të fshehtë Basha – Rama

Nga: Andi Bushati

Të gjithë idhtarët e teorive konspirative, që së paku prej verës së 2017 fantazojnë për skenarin e një pakti të nëndheshëm Rama-Basha, tani e kanë edhe provën. Zëra zyrtarë nga PD-ja i janë bashkuar të singjashmëve të tyre rilindas, për të hedhur poshtë një nga nismat më progresive që i është paraqitur publikut shqiptar, duke i'u dorëzuar më pas në formë të zyrtarizuar parlamentit, atë për ndryshimin e sistemit me lista të mbyllura.

Thelbi i këtij projekti qëndron në vullnetin për t'u hequr kryetarëve të partive ekskluzivitetin e përzgjedhjes së deputetëve (pra dhe eliminimin sa më shumë të jetë e mundur të servilëve, të paaftëve apo banditëve) për tu'a kaluar atë dhjetra mijra votuesve të tyre.

Pikërisht, ky synim, për të mos lëshuar nga duart monopolin absolut që kanë mbi partitë respektive, e për rrjedhojë, mbi gjithë jetën politike të vendit, i ka bashkuar në një barrikadë kundër interesit të përgjithshëm të qytetarëve, Ramën dhe Bashën.

Në thelb, ata po përsërisin të njëjtën marrëveshje që bënë Berisha dhe Rama, në prill të 2008-ës, kur ndryshuan kushtetutën dhe sistemin zgjedhor, duke rritur fuqinë e kryeministrit përballë mocioneve, duke dobësuar peshën e deputetëve, duke minimizuar pushtetin e presidentit, për të shkuar drejt një kompromisi të shpifur: ai që është në qeveri i ka të gjitha, ai që është në opozitë i humb të tëra.

Së çfarë pushteti i dha ky pakt Berishës, për të shkatërruar dosjen e Gërdedit, ku dilte familjarisht i përlyer, se si e "trimëroi" atë drejt masakrës së 21 janarit dhe grabitjes së zgjedhjeve të Tiranës, kjo nuk ka nevojë të rikujtohet. E vetmja gjë që i'a vlen për krahasim është fakti se kjo lloj gjithpushtetshmërie, po i lejon Ramës të grabisë, bashkë me oligarkët, përmes koncesioneve që voton me delet e tij në kuvend.

Të njëjtin sistem: ai që fiton zgjedhjet i ka në dorë të gjitha, pa fre dhe pa kontroll, po kërkojnë të instalojnë për dekadën e ardhshme, Basha dhe Rama, duke refuzuar ndryshimin formulës për përzgjedhjen e deputetëve.

A do t'i duhej edhe më shumë për t'u bindur një idhtari të teorive konspirative, që beson në një pakt të fshehtë mes tyre?

Në fakt ka edhe më. Dhe provën për këtë e jep Lulzim Basha.



Asnjë lider opozite, i pajisur me një aparat normal arsyetimi, nuk do të kishte guximin të humbiste me një të rënë të lapsit 50 mijë votues potencialë, të cilët i kanë kërkuar me nëshkrimet e tyre ndryshimin e sistemit zgjedhor.

Asnjë mëtonjës pushteti, nuk do ta shpërfillte kaq mendjelehtësisht krijimin e konsensusit rreth vetes ndërkohë që prej gjashtë vitesh luan teatrin e republikës së re dhe të dëgjimit të zërit të qytetarit.

Asnjë sfidant real i kryeministrit, nuk do të tregonte këtë shpërfillje ndaj meritokracisë të përzgjedhjes së deputetëve, ndërkohë që bën thirrje për hapjen e partisë.

Në fakt, Basha i ka bërë të gjitha këto dhe kaq është mëse e mjaft-

tueshme për të yshtur fantazinë e të gjithë atyre që duan të besojnë se ai ndan paratë me Ramën, se merr benefice prej të njëjtëve oligarke, se kanë interesa të përbashkëta dhe se në thelb, nuk duan "t'a vrasin njëri-tjetrin".

Dua ta them që në fillim, unë nuk jam njëri prej atyre që besojnë në këtë konspiracion. As nuk i imagjinoj, të dy, të ulur në një tryezë mëkatarësh, apo duke shkëmbyer mesazhe dhe bërë plane për fitime reciproke. Deri në një provë të kundërt, mendoj se Basha dhe Rama janë vërtet armiq, se ata nuk do të ngopeshin duke e parë keq e më keq njëri-tjetrin.

Por, e veçanta është se ata janë armiq të një lloji të veçantë. Ata urrehen, mund të kacafyten madje dhe të vriten për të pasur për vete karrik-

en e kryeministrit dhe ato pak metra katrorë që ofron zyra e tij. Por, përtej kësaj, ata nuk janë aspak të tillë, për të ndryshuar modelin e qeverisjes së vendit.

Ata duan ti marrin njëri-tjetrit gjithçka, pa i dhënë shqiptarëve asgjë. Ata janë gati ti vënë zjarrin me molotov zyrës që s'e marrin dot, më kollaj se t'a ndajnë pushtetin që buron prej saj edhe me të tjerë.

E në këtë pikë, paradoksalisht, ata janë po aq armiq sa dhe bashkëpuntorë. Ata nuk kanë asnjë pakt për atë që i ndan, por janë krejt në dakordësi për atë që i bashkon. Ajo përmbledhet shkëlqyeshëm në frazën lapidare të Giuseppe Tomasi di Lampedusa: "Të ndryshojmë gjithçka, për të mos ndryshuar asgjë".

# Mesazhi i qartë i Holandës: Me Edi Ramën negociatat nuk hapen as në 2020, mbron korrupsionin

Edi Rama mashtroi shqiptarët duket festuar çeljen e negociatave në vitin 2018, por negociatat nuk do të hapen as në vitin 2020, për shkak të pesëfishimit të korrupsionit qeveritar gjatë gjashtë viteve të fundit.

Në 26 qershor të vitit 2018, Edi Rama shkruante: "Pas 72 orësh mes dallgëve të brendshme të BE Shqipëria ia doli të marrë datën për hyrjen në portin e Evropës së Bashkuar. Rezultatet e reformave tona bënë që dhe më skeptikët të njohin meritën e Shqipërisë e të Maqedonisë. Një betejë tejet e vështirë u fitua lufta vijon".

Sot, anija e drejtorëve, ministrave dhe deputetëve të korrumpuar po lundron në detin e korrupsionit, nën drejtimin e kapitenit Edi Rama. E vetmja meritë që Brukseli po i njeh qeverisë së Edi Ramës është thellimi i kulturës së pandëshkueshmërisë, rikthimi i censurës me një ligj antidemokratik, mashtrimi me rezultatet në luftën kundër korrupsionit, tentativave për të kapur drejtësinë e re me drejtorët e qeverisë etj.

Ndërsa Edi Rama tha në vitin 2018 se negociatat u hapën, përfaqësues të Holandës, kanë paralajmëruar se Shqipërisë nuk do t'i hapen negociatat as në vitin 2020, për shkak të korrupsionit. Duke u dhënë një mesazh të qartë shqiptarëve se me Edi Ramën kryeministër Shqipëria nuk avancojnë në rrugën e integritetit, ministri i Jashtëm i Holandës Stef Blok ka thënë për median kroate se "Përpara fillimit të negociatave të pranimit, Shqipëria do të duhet të tregojë një angazhim të qëndrueshëm për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Këshilli Evropian do të kthehet në këtë çështje para Samitit të Ballkanit Perëndimor në maj të vitit 2020". Mesazhi është shumë i qartë se pa ndëshkuar kokat e korrupsionit nuk ka hapje të negociatave. Po pse përgjegjësia bie vetëm mbi Edi Ramën?

Ashtu si KLD mbron korrupsionin e gjyqtarëve, është Edi Rama ai që mbron korrupsionin e ministrave dhe drejtorëve, duke i inkurajuar. Në media denoncohen çdo ditë afera të drejtorëve të caktuar. Edi Rama nuk i largon, duke u dhënë një mesazh të qartë që të vijojnë vjedhjen.

Nga ana tjetër, Holanda ka paralajmëruar ndarjen e Maqedonisë nga Shqipëria këtë vit sa i takon negociatave. Një gjë e tillë është kërkuar



edhe nga vende të tjera. Deri më sot Edi Rama është fshehur pas Maqedonisë, e cila është penalizuar nga qeveria e Bablokut. Ministri i Jashtëm i Holandës Stef Blok tha se "Maqedonia Veriore ka bërë shumë përparim në drejtim të reformave të sundimit të ligjit. Dhe marrëveshja e Prespës

midis Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut shërben si një shembull për rajonin". Maqedonia ka treguar vullnet në luftën kundër korrupsionit, duke dënuar ish-kryeministrin Gruevski, të cilin e ndihmuan Edi Rama dhe Ilir Meta të arratisesh nga Shqipëria për t'i shpëtuar burgut.

Në një kohë kur kryeministri dhe ish-kryeministrat tani vijojnë të pasurohen duke vjedhur paratë dhe pronat publike, të tentojnë kapjen e drejtësisë së re dhe të sundojnë Shqipërinë, Maqedonia e ka dënuar për korrupsionin ish-kryeministrin e saj.

## Qeveria duhet të ndërhyjë, Buxhuku: Çmimi i naftës mund të rritet edhe në Shqipëri, nëse ndodh, është shkatërruese

Edhe pse tregjet u stabilizuan pas tronditjes nga konflikti SHBA-Iran, ende mbetet rreziku që pasojat e reflektuara te çmimi i naftës të ndihen edhe në Shqipëri.

Në një intervistë për RTV ORA, Kryetari i Konfindustrisë, Gjergj Buxhuku, u shpreh se qeveria duhet të marrë masa, që luhatjet e çmimit të naftës të mos prekin vendin tone.

Nëse ndodh thotë ai, do të ishte e papërballueshme për qytetarët dhe bizneset. Buxhuku thotë se rënia e çmimit të naftës një ditë më parë, lidhet drejtpërdrejtë me retorikën e luftës mes dy vendeve.

"Që të shohim strukturimin e tregut të naftës, të mos ta lëmë vetëm në dorën e grupimeve oligopoliste dhe të tipit kartel. Detyra e shtetit kryhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga autoritetet rregullatore që janë të pranishme, teorikisht formalisht, por jo praktikisht. Ka dhe mënyra të tjera, të cilat ne ja kemi rekomanduar ekzekutivit shqiptar. Për këtë mjafton të shohim shembullin e Maqedonisë".

Shqipëria është një ndër vendet me çmimin më të lartë në rajon.

Stabilizimi i marrëdhënieve mes SHBA dhe Iranit u reflektua në kohë reale dhe në çmimin e naftës në bursa.





# TËRMETI DHE MALËSORI SHTATLARTË

Malësori, një burrë me shtat të lartë, me shpatulla të gjëra, sapo zbriti nga kamioni, futi duart në xhepin e brendshëm të xhakëtës dhe nxori portofolin. Shoferi e kuptoi dhe ia preu shkurt:

- Nuk ke me pagua gja.

Malësori e shikoi drejt, me sytë e tij që kishin gjithmonë një shprehje krenarie dhe i tha duke buzëqeshur:

- E po t'u rrit ndera, or mik!

Të kjoftë udha e mbarë dhe na urdhno ndonjiherë nga katundi.

- Po, po! Kam me ardhë! - tha shoferi dhe pasi përshëndeti me dorë nisi kamionin. Malësori ende buzëqeshte e mendonte me vete: "Për besë, ka edhe djelm të mirë!"

Vellua e errësirës kishte nisur të mbulonte tokën. Ai me kryet lart si malet, bëri përpara. Ecte dhe trupin e mbante drejt. Moshha nuk i a pat përkulur kurrizin. Mori rrugën e fshatit që çante më dysh bregoret e maleve të mbuluara me dëborë. Dëborë kishte edhe mbi kodrina, mbi livadhe, mbi drurë, edhe në rrugë dëborë kishte. Ajo i jepte një pamje të bukur këtij peisazhi malor. Ai ndjeu erën e ftohtë dhe dehëse të natës, kopsiti xhyben e trashë, ngriti jakën e saj dhe ecte i çkujdesur. Nën këmbët e tij të mbathura me opinga dhe çorape leshi, dëbora kërciste "krrap-krrap-krrap". "Me siguri ata s'më presin- mendoj me vete.- Ata e dinë se unë jam ende në spital". Ai çante nëpër dëborë dhe mendja i rrinte atje, tek shtëpia e rrënuar nga tërmeti, tek njerëzit. Ai kishte dëgjuar për ditë në spital lajmet e gëzueshme që jepnin gazetatat dhe radioja se nga i gjithë vendi kishin shkuar për të ndihmuar. Malësori i dëgjonte këto lajme dhe herë herë rrinte si i habitur. Aty në çarçafët e bardhë të spitalit ai kishte kujtuar disa herë çastin

kur toka u drodh, kur u ndje një zhurmë shurdhuese, kur një tra e zuri për fundi... Herë herë para tij hapeshin kujtime të largëta që e bënë në psherëtinte.

Ai e mbante mend mirë se edhe një herë tjetër pat rënë tërmet. Kishte shumë e shumë vjet. Atëhere pat qënë fëmijë. Shumica e shtëpive ishin rrënuar. Edhe atëhere kishte qënë dimër. E këta ishin struktur ku të mundnin nga të ftohtit. I kujtohej se si e shtrëngonte e ëma në gjoks për ta ngrohur. E ai qante, ca nga të ftohtit e ca nga tmerri, kur shikonte shtëpinë të kthyer në gërmadhë. I ati pat kërkuar andej këndej nëpër miq të holla për të rregulluar shtëpinë, por edhe miqtë ishin për t'u qarë hallin. Sa shumë kishin vuajtur ata dhe sa vjet iu desh të jatit të tij ta rregullonte shtëpinë! Këto shkonte ndërmend pothuaj çdo ditë në spital dhe një mëngjes i tha mjekut:

- Or zoti doktor! A po m'lëshon se due me ikë?!

- Si ore, të ikësh! - i tha mjeku. - Do të lëshojmë kur të jesh shëruar mirë.

- Jo, besa, der at'here s'jam tue ndej- tha malësori. Plaga pothuajse më asht mbyllë. Mandej ju a po ndigjoni se ç'po bahet? Kanë shkue me na ndihmue e po ndërtojnë shtëpitë tona e unë me ndej hala këtu. Jo he burrë, mos më koritni!

Mjeku qeshi. Më në fund, mbasi ja mjekuan edhe njëherë plagën dhe i dhanë porosi që të mos punonte, e lejuan të delte nga spitali. Ecte dhe nën këmbët e tij dëbora kërciste "krrap-krrap-krra-krrup". Në mend kujtonte fshatin, si e la para dhjetë ditësh, shtëpinë, njerëzit... "C'bënte Prenga, Mrika, Lokja? A do jenë strehues në ndonjë shtëpi"...Po i afrohej fshatit. Tej dukeshin disa drita që lëviznin si xixël-lonja. U afrua dhe ca dhe dalloj në duar

fenerë dhe pishtarë të ndezur.

Nuk u përmbajt më, por thirri:

- Or ju shokë! Një zë ju përgjigj: - Eeej.

- Çka ndodhë që po bridhni natën me pishtarë?

- Kush je ti? - pyeti njëri.

- Jam Ndou, bre, Ndou!

Një djalë 15 vjeçar sa dëgjoi këtë zë të njohur u turr me rrëmbim drejt tij dhe thirri:

- Babë! A je ti babë? Jam unë Prenga.

Ata u pushtuan të dy at e bir, të për-malluar si të ishin ndarë prej vitesh dhe s'gjenin fjalë për të kuvenduar. S'të kena prit sonte, babë, si ke ardhë, ti akoma s'je shëruë?- e theu akullin djaloshi. Jo, bir, jam shëruë. Plaga pothuajse m'u ka mbyllë. Pastaj, bir i babës, si mujsha unë me ndejtë atje. Erdha dhe unë me punue.

- Po, babë, ashtu asht. Djaloshi shikonte fytyrën e hequr të të jatit me një ndjenjë të thellë dashurie. Në atë kohë ishin afruar njerëz të tjerë. Nën dritën e zbehtë të fenerëve, Ndou pa fytyra të pan-johura? Prenga ju drejtua të jatit: - Babë, këta kanë ardhur për të na ndihmuar. Malësori u shtrëngoi duart fort dhe i rroku në qafë. Prenga foli përsëri: - Asht baba jem. Ka kenë në spital, se u plagos ditën kur ra tërmeti. Miqtë e rrethuan prapë të porsaardhurin dhe ky i shikonte me dashuri ato fytyra të ngurosur nga të ftohtit, por që sytë e tyre shprehnin gëzim e forcë. "Ndoshta s'kanë pa ndonjiherë borë e s'kanë ndje kësi të ftohti të madh" - mendoj me vete. "Tani ata mund t'i gjejshe në ndonji dhomë të ngrohtë së bashkut me familjet e tyre, tue përkëdhelë fëmijët, tue lexue ndonjë libër apo tue pjekë gështenja

të ngrohta. Por ata kanë mendue ndryshe. Kanë mendue për të mirën e të tanëve."

Pa e zgjatur ju drejtua atyre:

- Çka po bani tash natën?

- Po mbajmë trarë e tulla, - tha një nga të ardhurit.

- Babë! - iu drejtua menjëherë Prenga. Shtëpinë tonë na e kanë ndër-tue të re. Ke me e pa sa të bukur e kanë ba.

- Si! Kaq shpejt u ndër-tue? - pyeti i habitur Ndou. S'ma ka prit mendja të bashsha kaq shpejt me shtëpi të re. Miqtë buzëqeshnin. Buzëqeshte dhe Prenga. "Sa i lumtur jam që ja mbrina kësaj dite, mendonte me vete Ndou dhe kujtonte ato vite vuajtjesh..."

Po i afrohejshin vendit ku më parë ndodhej shtëpia e vjetër. Atje në vend të saj ngrihej një tjetër e re.

Disa pika lotë filluan t'i rrjedhin në faqet e tij të ashpra. Ishin lotë gëzimi. Fytyra e tij, e pjekur nga dielli dhe era, me sy të mëdhenj, me vetulla të trasha, shkëlqente dhe dukej sikur shkrihej e tëra në botën që e rrethonte. Donte të thërriste, por e mbajti veten.

- Babë! Kanë me na ardhë dhe dritat shpejt.

- Po bir! Kanë me na ardhë.-tha ai dhe me kryet gjithmonë lart ju afrua pragut të shtëpisë, ku ju duk se lindi dhe njëherë.

Pastaj malësori duke u kthyer nga miqtë ju drejtua atyre:

- Urdhnoni, o burra, urdhnoni. Se po ma don zemra t'iu kem miq sonte, në votrën teme. Ata hynë një nga një e pas tyre malësori që shinte atje tej, larg, dritat e një kamioni që ngjitej qafës së malit.

1967, Alfred Papuçiu



# VËSHTRIM KRITIK MBI VEPRËN E GJEÇOVIT “KANUNI I LEK DUKAGJINIT”

Për veprën e Gjeçovit janë mbajtur shumë simpoziume dhe takime qysh nga vdekja tragjike e tij në vitin 1929, madje për veprën e tij janë mbajtur takime studimore edhe në të gjallë të tij.

Falënderoj organizatorët që me rastin e 90 vjetorit organizuan këtë simpozium plotësisht të merituar për veprën shkencore por edhe patriotike të këtij atdhetari të madh.

Gjeçovi gjatë jetës së tij 55 vjeçare zhvilloi një aktivitet atdhetar por edhe shkencor, duke na lënë një trashëgimi të pasur në fusha si arkeologjia, etnografia, folklori etj duke mbledhur këngë, valle, gojëdhëna mitologjike, gjë e gjëza, fjalë të urta, proverba dhe materiale të tjera të cilat u botuan në fillim të shekullit të kaluar në revistën “Visaret e Kombit”. Në harkun kohor prej gjashtë vitesh, nga viti 1904 deri në vitin 1910, ai botoi 5 vepra dhe përkthime.

Gjatë regjimit komunist në Shqipëri, me gjithë luftën e madhe që u zhvillua kundër fesë dhe veçanërisht ndaj klerit katolik, vepra e Gjeçovit u vlerësua duke i njohur meritën e krijimit të Arkeologjisë Shqiptare, duke e dekoruar me rastin e 50 vjetorit të shpalljes së pavarësisë në vitin 1962 me Urdhër “Për Veprimtarin Patriotike” të klasit III dhe duke botuar për jetën dhe veprimtarinë e tij një monografi me titull “Shtjefën Gjeçovi Jeta dhe Veprat” e shkruar nga Ruzhdi Mata, shtypur në shtypshkronjën “Mihal Duri”, Tiranë 1982.

Përballë veprës kolosale atdhetare dhe shkencore të Gjeçovit, edhe ai regjim u detyrua t’i njihnte shumë nga meritat e tij. Pushka e Gjeçovit u vendos në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë qysh në vitin 1970.

Presidenti Rugova, me datën 10 qershor 2003, e ka dekoruar At Shtjefën Gjeçovin me “Medaljen e Artë të Lidhjes së Prizrenit”.

Është detyra jonë që të identifikojmë dhe të nxjerrim në dritë veprën e plotë të këtij kolosi të atdhetarisë dhe të letrave shqipe dhe të sensibilizojmë organet përkatëse shtetërore dhe politike në Shqipëri dhe në Kosovë për të vënë në vendin që meriton figurën e



këtij patrioti të madh.

Tema ime do të jetë e përqendruar nga një këndvështrim kritik, por njëkohësisht edhe dashamirës dhe jo denigrues për veprën madhore “Kanuni i Lek Dukagjinit” që e ka bërë të pavdekshëm emrin e autorit të sajë.

Edhe pse janë shkruar me qindra artikuj studimorë mbi këtë vepër, duke e etiketuar në forma nga më ekstremet, nga cilësimi si një kryevepër deri në mallkim të sajë si një vepër që bën të ekspozohen anët më të errëta të realitetit shqiptar, vazhdojnë akoma të shkruhen pa fund studime dhe referate për të.

Analizën më të saktë dhe të koncentruar të kësaj vepre e ka bërë në hyrje të botimit të parë të sajë korifeu i letrave shqipe Atë Gjergj Fishta.

Në sesionin shkencor që u mbajt në Zllakuqan me datë 25 korrik 2017 jam paraqitur me një temë me titull “Gjakmarrja në veprën e Shtjefën Gjeçovit”. Aty kam folur me hollësi për problemin e gjakmarrjes dhe trajtimin e këtij fenomeni nga Kanuni i Lek Dukagjinit. Tema është e botuar dhe mund të gjendet me lehtësi, prandaj sot nuk do ta trajtoj aspak këtë temë.

Në vitin 1960, në revistën shkencore “Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës”, Seria Shkencat Shoqërore, volumni II, faqe 95, është botuar një studim mjaft serioz nga studiuesja ruse J.

V. Ivanova mbi veprën “Kanuni i Lek Dukagjinit”.

Në vijim të studimit të sajë, kjo studiuese, në faqen 96, për të kuptuar më mirë veprën e Gjeçovit ajo ka shtruar tre pyetje:

Cilës kohë i përkasin informatat që sjell ai në veprën e tij; Në çfarë trualli ka vepruar Kanuni i Lek Dukagjinit;

Në çfarë rrethanash konkrete historike ka lindur Kanuni dhe në cilat ambiente shoqërore ka pasur fuqi.

Të tria këtyre pyetjeve ajo është rrekur t’u japë përgjigje nga këndvështrimi i sajë që, për hir të së vërtetës, për arsye të rrethanave politiko shoqërore të kohës, nuk mund ti shmangej krejtësisht ndikimit të ideologjisë zyrtare të kohës që ishte regjimi komunist.

Në temën time, do të përpiqem edhe unë, të jap versionin tim për këto tri pika, pa kopjuar idetë ose pikëpamjet e kësaj studiueseje të nderuar.

Nga të dhënat e publikuara deri sot pranohet që shënimet për kanunin e Lek Dukagjinit, rreth dy mijë faqe dorëshkrime, Gjeçovi i mbledhi nga viti 1907 deri në vitin 1915 në famullinë e Gomsiqes ku punoi rreth 8 vjet.

Informatat që sjell në këto shënime, u përkasin këtyre viteve dhe vendi ku këto rregulla zbatoheshin ishin kryesisht krahina rreth e rrotull famullisë së tij dhe në Mirditë.

Mbledhja, por sidomos kodifikimi i ndarë në nene dhe kapituj të veçantë, është një punë shkencore që ka kërkuar shumë kohë dhe mund nga autori, dhe është një meritë e jashtëzakonshme e tij.

Zonat ku zbatoheshin kanuni me emrin Lek Dukagjini ishin kryesisht zonat katolike në fiset e Malësisë së Madhe, Nikaj Mërturi, Shala dhe Shoshi, 12 bajrakët e vegjël të Pultit, Thaçi, Berisha, Malësia e Lezhës dhe bajrakët e Mirditës.

Autorja që citova më sipër shkruan se ky kanun zbatoheshin edhe në Krasniqe, Gash, Bytyç, Has, Lumë dhe disa vende të tjera me popullsi të besimit mysliman gjë që nuk është e vërtetë.

Në zonat me popullsi të besimit mysliman krahas kanunit ka vepruar edhe sheriat që ishte një e drejtë që e

praktikonte pushtuesi turk në shumë zona.

Madje edhe në zonat me popullsi të besimit katolik që përmendëm më sipër, ky kanun nuk ka vepruar kudo njëjloj por ka dallime të theksuara.

Dera e Gjo Markut e kodifikuar në këtë përmbledhje të Gjeçovit i ka patur ato privilegje vetëm në bajrakët e Mirditës, por jo në zonat e tjera.

Në zonat me popullsi të besimit të krishterë dhe mysliman, fqinje me Mirditën ka vepruar një tjetër kanun i njohur si “Kanuni i Skënderbeut”. Ky u mbledh dhe u kodifikua nga Imzot Frano Ilia dhe u botua nga Arqipeshkvia e Shkodrës në vitin 1993. Zona e Kurbinit ku vepronte ky kanun është shumë e përzier nga ana gjinore me popullsinë e fiseve të Mirditës.

Edhe studiuesi Xhemal Meçi ka botuar një përmbledhje mbi të drejtën zakonore me titull “Kanuni i Lek Dukagjinit, Varianti i Pukës”

Në fakt Gomsiqja ku e mori lëndën kryesore Gjeçovi për veprën e tij, është quajtur historikisht pjesë administrative e Pukës, edhe pse është me popullsi të përzier të fiseve nga Puka dhe Mirdita.

Nëse marrim parasysh ndryshimet e kësaj të drejte zakonore që vepron në fise pak më të largëta nga Gomsiqja si Nikajt, Mërturi, Berisha, Shala, Shoshi, Shkreli, Kelmendi, Hoti, Gruda etj atëherë rezulton që ky kanun nuk është i njëjlojtë në zonat që përmendëm.

Edhe Xhafer Martini dhe Shefqet Hoxha kanë mbledhur të drejtën zakonore për Dibrën dhe Lumën, krahina relativisht afër me zonën ku Gjeçovi mbledhi materialet për veprën e tij.

Me këto që shkruam më sipër marrin përgjigje dy pyetjet e para ndërsa për pyetjen e tretë duhet të ndalemi edhe pak. Kur e ka zanafillën Kanuni asnjëri nuk mund ta thotë me kompetencë fjalën e tij sepse fatkeqësisht janë dy shkaqe kryesore që nuk e mundësojnë hedhjen dritë mbi këtë pikë. Së pari, në Shqipëri pushtuesi turk, gjatë kohës që e mbajti të pushtuar, ka dëgjur dhe shkatërruar çdo gjë të shkruar dhe së dyti vendi ynë ka qenë i nënshtruar disa pushtuesve si romakët, serbët, bullgarët dhe në fund edhe turqit.

Secili pushtues, në kohën e sundimit të tij, ka zbatuar dhe ju ka imponuar ligjet e veta popullsisë së nënshtruar. Janë të njohura ligjet e Kostandinit të

Madh, të Justinianit, Kodi i Dushanit dhe disa ligje të tjera të cilat në periudha kohe të përcaktuara, janë zbatuar në popullsinë shqiptare. Po ashtu, gjatë sundimit rreth 500 vjeçar të pushtesit turk, zbatimi i disa ligjeve të pushtesit ka qenë detyrim. Edhe e drejta kishtare e shkruar në disa kapituj të Biblës, duhet të pranojmë që në popullsinë e krishterë ka pasur ndikimin e vet.

Nuk jemi në gjendje për të përcaktuar me saktësi ndikimin e secilit nga këto ligje, cili ka më shumë ndikim në Kanunin e Lek Dukagjinit por, sipas mendimit tonë, secili nga këto ka, pak a shumë, një farë ndikimi mbi të.

Mbas vitit 2000 studiuesja italjane Luçia Nadin dhe studiuesi shqiptar Pëllumb Xhufi kanë publikuar Statutet e Shkodrës nga një kopje dorëshkrim e ruajtur në Bibliotekën e Muzeut Correr në qytetin e Venecies.

Ky dokument me rreth njëqind faqe, është shkruar rreth vitit 1479 dhe ka një rëndësi të jashtëzakonshme për studimin e së drejtës penale dhe zakonore në truallin Arbëror dhe për këtë është shkruar dhe diskutuar shumë në Shqipëri dhe jashtë sajë, por unë e përmenda këtë për faktin se në asnjërin nga nenet e këtij Statuti nuk përmendet gjakmarrja.

Shkodra ka qenë qyteti kryesor për rrethinat ku ka vepruar Kanuni i Lek Dukagjinit dhe ne nuk jemi në gjendje të themi se sa kanë pasur ndikim statutet e Shkodrës në popullsinë e rrethinave të sajë. Nuk jemi në gjendje as të themi me siguri se kur ka filluar të shfaqet fenomeni i gjakmarrjes në formën që kishte kur shkroi Gjeçovi veprën e tij.

Në veprën e Gjeçovit nuk thuhet se kur ka filluar të shfaqet fenomeni i gjakmarrjes në mënyrë të frikshme siç ishte në vitet e fundit të pushtimit turk.

Mbetet detyrë parësore e studiuesve tanë për të bërë kërkimet e nevojshme në arkivat e ndryshme, kryesisht në ato të Romës, Venecies dhe Dubrovnikut për të parë se si ka evoluar ndikimi i kanunit në zonat ku ai pati ndikim.

Kanuni në secilin lloj ose variant, zbatohet brenda një njësie jo shumë të madhe që njihet me emrin fis ose bajrak.

Fise quhen grupime pak a shumë të mëdha banorësh që e kanë prejardhjen nga një i parëlindur dhe kanë të gjithë lidhje gjaku midis tyre. Nuk ka qene zakon të bëheshin martesë brenda fisit as kur ishin larg njëzet breza. Në kanun ishte e ndaluar martesë brenda fisit “edhe në 400 breza”, mjaft që lidhja e gjakut të ishte e njohur dhe e konfirmuar mirë.

Bajraku është një njësi territoriale me banorë që ishin të lidhur nën një flamur por jo domosdoshmërisht kishin lidhje gjaku midis tyre.

Në disa punime është shkruar se ba-


jrakët dhe bajraktarin i krijoi pushtuesi turk. Kjo nuk me duket shumë e besueshme sepse asnjë shtet nuk mund të krijojë as fshatra as qytete as fise por ai, mund të bëjë ndarje administrative mbi bazën e fshatrave, qyteteve apo fiseve dhe të krijojë llojin e administratës që e vlerëson më të vyer. Organizimin administrativ mbi bazë bajraqesh pushtuesi turk e ka përdorur, më së pari në shekullin XVIII. Ai u ka njohur pushtetin bajraktarëve, ju ka dhënë disa kompetenca dhe ju ka njohur disa privilegje, dhe ka lejuar qeverisjen jo sipas ligjeve të shtetit por

nuk zbatonte vendimet e miratuara. Masat shtrënguese kanë qenë shumë të rrepta dhe fillonin nga gjrobat që mund të ishin me para ose me shtrimin e drekave ose darkave për të gjithë komunitetin, dhunimi publik duke e detyruar fajtorin të merrte një gur të rëndë dhe ta transportonte i vetëm në një distancë që ata e shikonin të arsyeshme, dëbimi për tre vjet ose përgjithmonë nga vendbanimi dhe shkatërimi i të gjitha pronave dhe djegia e shtëpisë. Në raste ekstreme ishte vrasja e personit fajtor ose vrasja kolektive. Vrasja kolektive ishte kur fajtori bënte

monë por ishte në përpunim dhe ndryshim të vazhdueshëm dhe nuk ishte kudo i njëjtë.

Edhe pse janë shkruar shumë studime mbi të drejtën zakonore shqiptare gjatë afër 150 vjetëve të fundit, jam i mendimit se ka akoma shumë hapësira të pa studiuar dhe ka vend për studime të tjera të bazuara në të dhëna arkivore dhe jo nga mbledhja gojore në komunitetet ku zbatohet.

Shkrimi i të drejtës zakonore mbi bazën e intervistave dhe tregimeve nga banorët e komuniteteve pa u thelluar në literaturë dhe në dokumente arki-



sipas të drejtës zakonore.

Edrejta zakonore pësonte rregullime dhe ndryshime sa herë banorët e shikonin të arsyeshme. Ndryshimi bëhej nga mbledhja e të gjithë pjesëtarëve të fisit ose bajrakut, duke marrë pjesë siç thuhej “burr për shpi” çka nënkuptonte që të ishte i pranishëm në kuvend nga një pjesëtar mashkull nga çdo familje e komunitetit. Vendimet merreshin me shumicë absolute me votim të hapur. Ato ishin të detyrueshme për zbatim nga të gjithë komuniteti pa përjashtim, përfshirë edhe parinë. Së bashku me vendimet përcaktosheshin edhe sanksionet për cilindo që

një krim që fyente rëndë nderin dhe dinjitetin e fisit. Në këtë rast, fajtori lidhej dhe vendosej në një shesh dhe vritej duke e qëlluar të gjithë me armë.

Vendimet që merreshin ishin në shumë raste specifike vetëm për një fis ose bajrak dhe në këtë kuptim, Kanuni i njërit fis, mund të mos ishte i njëjlojtë me atë të fisit tjetër. Edhe në Kanunin e hartuar nga Gjeçovi, në shtojcën që është vendosur në fund bëhet fjalë për vendime të fiseve ose të djelmnisë të cilat janë marrë në kushte të caktuara për probleme të caktuara. Ky është shembulli i ilustrues më i mirë që Kanuni nuk ishte i shkruar njëherë e përgjith-

vore, jep një produkt që lë shumë për të dëshiruar në lidhje me cilësinë dhe saktësinë e tij.

Gjeçovi ka meritën që ishte i pari që bëri mbledhjen dhe kodifikimin e kësaj të drejte zakonore, por jam i mendimit se ajo duhet studiuar me sy kritik dhe të plotësohet me të dhëna të reja nga studiues profesionistë dhe institucione prestigjioze shtetërore ose nga shoqëria civile.

Ju faleminderit

**Nga Mark Palnikaj,**  
Tiranë me 07. 11. 2019

# “RRITJA PAS TRAUMATIKE”

## MUNDËSIA E PËRMIRËSIMIT TË VETVETES DHE E SHNDËRRIMIT TË ASPEKTEVE NEGATIVE TË JETËS NË NJË BURIM TË TRANSFORMIMIT POZITIV KOLEKTIV

Tërmeti i 26 Nëntorit tronditi mbarë shoqërinë shqiptare e cila u zgjua në mëngjes me panic dhe me ndjesinë për ta kthyer atë në një gënjeshtër. Në mbrojtje të një realiteti, qënia njerëzore është në gjendje të sajohet tipe të ndryshme gënjeshtërash për të mos lënduar të tjerët si psh gënjeshtër të bardha, gënjeshtër blu, gënjeshtër kompulsive dhe gënjeshtër patologjike. Më konkretisht çfarë ndodhi me ne në orët e para të mëngjesit të 26 nëntorit?

**1) U zgjuam me një gënjeshtër të bardhë-** në sferën sociale ka gënjeshtër të justifikuar, të ashtuquajturat gënjeshtër të bardha që pothuajse të gjithë ne i përdorim deri diku. Që nga koha kur mësojnë të flasin, fëmijët fillojnë të përdorin fjalë për të gënjer. Në psikologjinë e zhvillimit, e gjithë kjo, edhe pse mund të duket se është një kontradiktë, njihet si një shenjë e inteligjencës sociale. Prandaj, le të themi se ne dëshirojmë të përdorim gënjeshtërën si një lubrifikant shoqëror se nuk donim të besonim se lëkundjet sizmike të tërmetit morën me vete edhe fëmijë. Oh jo, kjo nuk mund të ketë ndodhur...Për më tepër, ne jetojmë, rritemi dhe jemi të edukuar në kundërshtimin më të pastër.

**2) U zgjuam me një gënjeshtër blu-** janë ato të ashtuquajturat gënjeshtër blu që i themi kur nuk i besojmë vetvetes, kur duam të jemi pjesë e një grupi social. Me ta mundohemi ta bëjmë veten të pranuar dhe të ndjehe mi të sigurt, por edhe nga frika e asaj që do të mund të ndodhë në të vërtetë. Vërtet ne u frikësuam sepse nuk donim të besonim që kishin mbetur njerëz nëpër rrënojat e tërmetit e aq më tepër që të ishin shuar edhe familje të plota. E gjithë shoqëria do të rrëzohej nëse nuk mund t'i besonim njëri-tjetrit, por në të njëjtën kohë, me siguri, nuk do të mbetej e tillë derisa të gjithë të thonin të vërtetën e derisa grupe të angazhuara shoqërore nën mandatin social dhe institucional të viheshin në lëvizje për të nxjerrë jashtë trupat e tyre apo për tu ofruar material bazike për jetën apo për të rindërtuar shtëpitë e tyre.

**3) U zgjuam me një gënjeshtër kompulsive** - janë të ashtuquajturat gënjeshtër kompulsive kur bëhemi të varur nga tregimet fantastike dhe vuajmë nga pasiguri e thellë. Në përgjithësi, njerëzit e vetëm që lëndohen nga kjo lloj gënjeshtre janë vetë ata. Ata quhen gënjeshtarë të detyrueshëm. Në fakt jemi mësuar të dëgjojmë dal vivo dhe të shohim në media se u ndërtaun

pallate e ndërtesa të bukura dhe e kemi detyruar veten të mos besojmë se tashmë ato ishin shembur dhe ishin kthyer në rrënoja. Dhe kështu ndodhi, edhe pse e detyruam veten, në të vërtetë, ne u plagosëm shpirtërisht kur njerëzit mbeten nëpër çadra, nëpër shtëpitë mikpritëse të tjerëve apo nëpër hotele etj.

**4) U zgjuam me një gënjeshtër patologjike** - janë të ashtuquajturat gënjeshtër patologjike kur tregohemi

pësuar humbje të një personi, kush ka mbetur, kush ka humbur diçka të rëndësishme, kush ka luftuar kundër vdekjes mund të mësojë t'i përshtatet erës dhe stuhive siç bëjnë pemët... dmth duke zhvilluar rrënjë të forta dhe degë. Çfarë parashikoi Guida Providenciale për ne? Shenjat pas një traume mund të shfaqen në forma të ndryshme, duke përfshirë edhe aspekte të rritjes si person..

Në lidhje me këtë të fundit,



të ftohtë dhe përllogaritës duke përmbytur objektiva dhe interesa specifike dhe zakonisht egoiste. Meqënëse shumë prej nesh kanë më shumë substancë të bardhë në zonën prefrontale të trurit kanë probleme me empatinë. Në fakt, një gjendje shtesë patologjike u krijua pasi për fatin jo të mirë mjaft njerëz nga shoqëria jonë luajtën rolin "sikur po u vijnë në ndihmë" personave që i shpëtuan lëkundjeve sizmike të tërmetit, njerëz të caktuar u sollën rreth e rrotull njerëzve në nevojë thjesht duke bërë një selfie apo duke treguar sjellje të tjera "fiktive"

Dhe ja, nga skenaret e krijuara në mënyrë të nënvetëdijshme të gënjeshtërave mbrojtëse, ne u futëm në Labirinthin Alkimik ku na nevojitej një Guidë Providenciale për të na treguar materien e parë aktive (prima materia) si dhe rrugën e kthimit. Gjatë këtij udhëtimit, ne përjetuam një traumë kolektive. Po, po, një traumë të vërtetë kolektive. Përvojat traumatike nuk janë një pikënisje e mirë; ato janë gjithmonë tragjike dhe psikologjikisht shkatërruese por ato mund të ofrojnë mundësi për tu rikuperuar. Kush ka

atëherë si është e mundur që pas vuajtjes të mund të përmirësojmë thellësisht jetën tonë? Dhe pse disa njerëz shtypen nga trauma, ndërsa të tjerët lulëzojnë përsëri?

Përjetimi i përvojave të rëndësishme dhe të dhimbshme sigurisht përfshin vuajtjet që manifestohen në marrëdhëniet me të tjerët dhe në jetën e dikujt. Por është gjithashtu e vërtetë që aspekte të reja të personalitetit mund të shfaqen nga vuajtjet. Sipas *prima materia* të psikologut Gustav Jung, kur dikush përvetëson vetëdijen, një pjesë e vetvetes, e cila deri në atë moment nuk ishte e panjohur, shfaqet dhe çdo marrëdhënie fillon të ndryshojë, duke supozuar tipare të reja.

Studimet tregojnë se shumë njerëz që kanë pasur një përvojë traumatike ose që janë përballur me prova jetësore tejet të ashpra, kanë treguar sesi përvoja të tilla negative mund të sjellin me vete një aspekt të fortë dhe të fuqishëm, duke përvetësuar një forcë misterioze të ndryshimit pozitiv dhe të rritjes personale.

Ne tanimë po flasim për një rrugë të kthimit nga trauma kolektive

e cila na orienton drejt një "rritje pas traumatike" që ka të bëjë me mundësinë e përmirësimit të vetvetes dhe të shndërrimit të aspekteve negative të jetës në një burim të transformimit pozitiv kolektiv. Mund të jetë një udhëtim i mundimshëm dhe rraskapitës por mund të hapë derën për një jetë të re. Është demonstruar gjerësisht se përvojat traumatike zakonisht çojnë në empati dhe altruizëm më të madh, duke përfaqësuar një motiv shtesë për të vepruar në interes të të tjerëve.

Në mbyllje; sa më shumë kemi pasur një përvojë traumatike për të treguar dhe për të kujtuar, aq më shumë kemi një Kopsht Edeni që pret të zbulohet. Sado i ngurtë të ketë qenë dimri, sado e dhimbshme vetmia dhe ndjenja e boshllëkut që ata kanë pësuar, gjithmonë ka në thellësi të secilit prej nesh një ballkon që pret të dalë në dritë: ballkoni ynë i brendshëm në kopshtin e natyrës dhe substancës. Ajo pjesë e jona që as ftohtësia e atyre që janë përreth nesh, dhe as pakujdesia dhe mungesa e respektit nuk arrijnë ta ndrydhin, të shkelin dhe ta vrasin.

Padyshim varet nga ne që të vendosim se çfarë duam të bëjmë me të: disa prej nesh janë të brengosur për mbrojtjen e tij, ngritjen e rrethojave shumë të larta. Dikush tjetër harron të dalë në ballkon e të ujisë. Në vend të kësaj, dikush e kultivon atë me dashuri, dhe kur ka mjaft lule, gjithashtu fton të tjerët ta shijojnë atë.

Përmbledhtazi, cila është forca misterioze që na lejon të dalim nga një situatë dëshpëruese dhe të kthehemi në një jetë të plotë? Ky qëndrim misterioz quhet "reziliencë" që përbën "Sekretin e rezistencës psikike..." për t'i rezistuar presioneve të mjedisit përreth; të presim përpara me optimizëm dhe për të vazhduar me atë vetëbesim i cili nuk e lejon veten të rrëzohet nga rrethanat, por synon me vendosmëri se çfarë është konstruktive.

Në këtë mënyrë, ne mund të gjejmë rrugën e kthimit të Labirithit Alkimik shqiptar, pa gënjeshtër ne mund të "rritemi pas traumës" duke treguar mirënjohje më të madhe ndaj jetës, identifikimin e mundësive të reja për ekzistencën e vetë personit, marrëdhënie më të këndshme ndërnjerëzore, një ndjenjë më të lartë të përgjegjësisë, jetë më të pasur shpirtërore dhe një lidhje me diçka më të madhe, një kuptim të forcës së brendshme.

Përgatitur nga:  
Suela NDOJA

# NJË DITË NË PREKAZ

Me 26 tetor 2019, pothuaj si ditë vere, me një diell pranveror, një grup prej katër vetash, anëtar të shoqatës atdhetare “Dukagjini”, me z Ndue Sanaj kryetar, Pashko Rajta dhe rapsodët Kol Aramadhi dhe Gjon Kosteri, u nisem nga Shkodra për në Prekaz të komunës Skenderaj për të marre pjese në veprimtarinë e VI të Ditës së Plisit

Kjo veprimtari ishte dita e fundit e veprimtarisë së VI të këtij manifestimi të përvitshëm, që organizohet në Kosovë prej gjashtë vjetësh, nga grupi organizator tashmë I njohur, aktori Ismet Krasniqi-LALA, shkrimtari Preng Buzhala, poeti Gjon Gjergjani dhe piktori Idriz Berisha

Ne ishim të ftuar në këtë manifestim tradicional.

Ne u nisem në mëngjes nga Shkodra për në Prekaz dhe arritëm në kompleksin e Jashareve rreth orës njëmbëdhjetë.

Pasi bame homazhe ne memorialët e Jashareve u nisem për tek kulla e Ahmet Delis, në Prekaz ku dhe organizohej manifestimi

Aty gjetëm qindra njerëz nga të gjitha trojet Shqiptare, që ishin pjese e kësaj veprimtarie, në Dita e Plisit

Në katin e dytë të kullës së Ahmet Delis ishte dhoma e burrave si kudo në trojet tona, në çdo kullë gurit ka një dhoma burrash, në të cilën nder shekuj janë mbledh burrat dhe kanë bërë kuvende dhe pleqërim për probleme të ndryshme

Një grup i vogël nga pjesëmarrësit u ngjit në katin e dytë të kësaj kulle nga shkallet e gurta tradicionale që ishin mjaft në gjendje të mirë.

Pasi u ulem rrafshit si burrat motit dhe u sistemuam, kulla nuk zinte më shumë se 40 vet, manifestimin e hapi z Ismet Krasniqi-LALA, i cili pasi uroj mirëseardhjen, përshkoi rrugën 6 vjeçare të kësaj veprimtarie, arritjet dhe vështirësitë në realizimin e saj. Ne fund u dha fjalën studiuesve dhe të ftuarve të ndryshëm.

Studiues nga të gjitha trojet etnike dhe diaspora folën për lashtësinë dhe vlerat e veçanta të Plisit Shqiptar

Plisi i bardh Shqiptar është më i vjetri në botë, madje vetëm shqiptaret njihen me Plisin e Bardhe, thanë folësit e ndryshëm.

Pas pak, me kërkesën e të pranishmeve, që ishin jashtë kullës, në oborr e saj, u vendos që manifestimi të zhvendosej në oborrin e kullës së Ahmet Delis

Në oborrin e kullës folën shumë studiues dhe në mes tyre edhe Ndue

Sanaj, i cili u ndal: Kënaqësi e dyfishte, së pari, marre pjese në këtë veprimtari, që sjell në ditët tona historinë e lashtësisë sonë të lavdishme dhe na thotë ne, brezit të sotëm e të ardhshëm, kush kemi qene dhe së dyti, përfaqësoj shoqatën atdhetare “Dukagjini” dhe përshëndes në emër të saj dhe në emër të rapsodëve Gjon Kosteri e Kole Aramadhi.

Grupi organizator, katërshja simpatike, aktori Ismet Krasniqi, shkrimtari Prend Buzhala, piktori Idriz Berisha e poeti Gjon Gjergjani, i ka bërë dhe vijon ti bëj një shërbim të madh nacionalitetit tonë, se ne duhet të dimë se kush kemi qene.

Ne kemi një prej ardhje shumë të lashtë në histori dhe me emër, çka na bën krenar. Robert d’ ANGÉLY, te libri “ENIGMA-nga pellazgët te shqiptarët”, thekson se fjala PELLAZG, do të thotë i BARDHË dhe jo i egër, siç theksojnë disa antishqiptar ... Profesor Xhuzepe Katapano ishte dhe mbetet i vetmi albanolog, që studioj në themel prejardhjen e racës ilire, në veçanti nëpërmjet veprës së tij të famshme “Thoti – fliste shqip”, 12 mije vjet më parë. Ka plotë studiues shqiptar e të huaj, që shkruajnë për pellazget, iliret dhe ne shqiptarët, pasardhës të tyre, që na bëjnë krenar për prejardhjen tonë. Prandaj e përsërisë, se këta katër burra të nacionalitetit tone, me këtë veprimtari që kane marre përsipër ta përgatisin e ta zhvillojnë në hapësirat e Dardanisë sonë, na bëjnë një shërbim shumë të madh të gjithë shqiptarisë dhe në emër të përfaqësuesve të shoqatës atdhetare “Dukagjini”, ju përgëzoje me gjithë forcën e shpirtit tim dhe ju uroj të vijoni me plote vitalitet ne vitet e ardhshme dhe besoj se vitin 2020 ta përgatisim e zhvillojmë në Kështjellën “ROZAFÄ”, në kështjellën e Agronit e Teutës, në Shkodrën tonë, ne bashkëpunim me Muzeun Historike të Shkodrës.

Ftesa e juaj, na bëri dy të mira, së pari të ndjejmë veten të privilegjuar që jemi përsëri pjese e kësaj veprimtarie dhe së dyti, futi në punë kryesinë e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, për të vlerësuar e nderuar katër kullat me emër të kësaj treve, të trevës së Skënderajve. Ajo, me propozim te kryetarit te këtij grupi, miratoi dhënien e titullit “Mehmet Shpendi”:

**Kompleksi Memorial “Adem Jashari”**, me motivacion: “Adem Jashari simbol i rezistencës, luftës dhe lirisë për bashkimin nacional.

**Kulla e Heroit Ilaz Kodra - “Kulla e Bashkimit”**, me motivacion: Top of Form Bottom of Form “Kulla e bashkimit, dijës dhe e pushkës, çerdhe e UÇK-së. Në këtë tempull u morën vendime të rëndësishme për nacionalitetin tonë. Kulla, që e ngriti vetëdijen tonë për liri e bashkim nacional”

**Kulla Muze e Tahir Mehës**, me motivacion: “Për rezistencën ndaj pushtuesit serb, Kullë muze ku ruhet trashëgimia shpirtërore, materiale e luftarake e popullit shqiptar”

**Kulla e Ahmet Delisë**, me motivacion: “Për trimëri e solidaritet ndaj popullit të vet. Kullë që e ngrit moralin e krenarin për të kaluarën dhe të ardhmen ndër breza”



*Akti i tij heroik pasuron fletët e historisë tonë të lavdishme. Prekazi për jetë rrezaton rreze lirie, këtu u shkrua me shkronja të arta historia më e re e nacionalitetit shqiptarë”*

**Kulla e Heroit Ilaz Kodra - “Kulla e Bashkimit”**, me motivacion: Top of Form Bottom of Form “Kulla e bashkimit, dijës dhe e pushkës, çerdhe e UÇK-së. Në këtë tempull u morën vendime të rëndësishme për nacionalitetin tonë. Kulla, që e ngriti vetëdijen tonë për liri e bashkim nacional”

**Kulla Muze e Tahir Mehës**, me motivacion: “Për rezistencën ndaj pushtuesit serb, Kullë muze ku ruhet trashëgimia shpirtërore, materiale e luftarake e popullit shqiptar”

**Kulla e Ahmet Delisë**, me motivacion: “Për trimëri e solidaritet ndaj popullit të vet. Kullë që e ngrit moralin e krenarin për të kaluarën dhe të ardhmen ndër breza”

\*\*\*

Propozimi dhe premtimi, që bëri Kryetari i Shoqatës, se në muajin tetor të vitit 2020, veprimtaria “Dita e Plisit” të organizohet e të zhvillohet në Kështjellën “Rozafa”, u prit me gëzim të veçante, me shumë duartrokitje dhe në fund të veprimtarisë me

shumë përqafime.

Në fund të këtij manifestimit u dha një program mjaft i pasur artistik, në të cilën grupi i ynë u paraqitem me dy kënge njëra maja krahu “Ka vjen dielli e ka bien hana Adem Jashar nuk ban ma nana” Dhe tjetra “Moj Kosovë mos thuaj se mbarova”, e cila u këndua nga Kole M Aramadhi dhe Gjon Kosteri.

Pas përfundimit të veprimtarisë, kryetari I komunës Skenderaj, organizoj një dreke për të pranishmit dhe të gjithë së bashku kaluam një mbas ditë të këndshme .

Në darkë, në Shkodër, pas një dite mjaft intensive pune dhe kujtime të paharruare po edhe me një detyrë tashmë shumë të vështirë, sepse sezonin e ardhshëm, në ditën përmblylëse të Ditës së Plisit, të veprimtarisë së shtatë do te presim miq nga gjitha trojet Shqiptare dhe diaspora në qytetin tonë, Shkodër Locen e të gjithëve.

Detyra dhe krenaria janë të mëdha për këtë veprimtari, por besoj se do ja dalim me faqe të bardhë të gjithë bashkë.

**Përgatiti  
Gjon Kosteri**



# HUMANIZMI I NJË MJEKEJE ZVICERANE, MIKE E SHQIPTARËVE

Duke lexuar Zhyl Vernin që është shprehur aq bukur : « Kur nuk krijoj, nuk ndjej jetë në veten time » mendova tu sjell sot kujtimet e mija te paharruara për një mjeke humaniste zvicerane, me të cilën kam punuar vite të tëra. Prej vitesh kam ndarë me të dhe personelin human mjekues, mjekë dhe infermiere në Gjenevë, para fillimit të një konsulte, « kruasantin » (croissant) dhe kafen e mëngjesit, duke diskutuar lirshëm dhe si midis kolegësh që na bashkon një qëllim : si të përmirësojmë bisedën me një pacient nga Shqipëria, Kosova apo nga viset, Maqedonia e Veriut, apo me bashkëkombës shqiptarë që janë vendosur në Zvicër, qoftë edhe përkohësisht. Kemi folur për atë gruan shqiptare që nuk dinte asnjë fjalë frëngjisht dhe dëshirën e saj për të kuptuar gjithçka nga biseda, për prindin e asaj fëmije që nuk ka konsultuar asnjëherë mjek në fshatin e saj, diku në Kosovë, për mungesë mjetesh dhe personeli mjekësor. Midis tyre, kam pasur rastin të marr pjesë dhe të diskutoj me doktoreshën humaniste zvicerane Marinette Eÿss, një njeri i qetë, në pamje e ashpër, por tepër modeste, fisnike, dhe e urtë, kur e njeh nga afër. Për të gjithë ata që kanë pas fatin ta njohin, ajo nuk linte asnjërin prej tyre indiferent. Kureshtarë, njerëzore dhe e dashur, ajo vazhdoi në rrevat e jetës, duke ecur në një « udhë » profesionale që dallohej nga autorësia e saj, për një trajtim të ri të sëmundjeve gjenetike, duke përfshirë edhe Talaseminë, që është e përhapur sidomos në zonat mesdhetare : Greqi, Itali, Qipro, Shqipëri, Francë, Belgjikë, Britani e Madhe, Turqi, Indi, Singapor, por edhe në vendet arabe, si Dubai, Oman, Irak, Tailandë, si edhe në Kanada, SHBA, si rezultat i migrimit. Doktoreshë Eÿss kishte aftësi të bashkëpunonte ngushtë dhe me kolegët e saj të spitaleve të tjera në Zvicër, por edhe jashtë, si për shembull edhe me profesorët shqiptarë të hematologjisë, Selaudin Bekteshin dhe Enis Boletin. Ajo komunikonte edhe me profesorin e shquar francez, Robert Girot, lidhur me pacientët shqiptarë që kuronte në Departamentin e Pediatriisë të Spitalit Kantonal Universitar të Gjenevës. Kohët e fundit, pata rastin të shfletoj letërkëmbimet e saj me prof. Enis Boletin, si dhe me prof. Robert Girot. Ajo shquhej për shpirtmadhësi dhe këmbëngulje për të trajtuar pacientët talasemikë me një terapi sa më bashkëkohore. Ajo ka shpëtuar shumë jetë fëmijësh dhe adoleshentë që vinin nga kontinente të ndryshëm, duke përfshirë edhe nga Shqipëria, Kosova dhe viset. Gjithçka që po shkruaj më poshtë, është një nga mijëra dëshmitë që mund të shkruheshin nga qindra njerëz që kanë biseduar dhe kanë ndeshur me këtë doktoreshë të jashtëzakonshme zvicerane.

Megjithëse i kisha shprehur disa herë dëshirën që të shkruaj për jetën e saj, ajo me modestinë që e karakterizonte nuk ka pranuar, pasi e quante veprën e saj, si

përkushtim modest ndaj profesionit që e kishte pranuar me dëshirë.

Marinette Eÿss lindi në vitin 1930, në një familje modeste zvicerane dhe shumë shpejt prirja e saj ishte mjekësia, studimi i sekreteve të trupit të njeriut dhe gjetja e rrugëve për të ulur sadopak dhembjet e atyre mijëra të sëmurëve që prisnin diçka më të mirë. Ajo me punën e saj si mjeke, qysh e re fitoi besimin e ekipit tjetër mjekësor, si dhe të pacientëve të shumtë. Komunikonte me ta me një gjuhë të thjeshtë, në frëngjisht, gjermanisht, italisht apo anglisht, kur kishte të bënte me pacientë, dhe me gjuhën mjekësore të mirëfilltë, me ko-



Te Shkëmbi i Kavajës, 7 gusht 2019

legë zviceranë apo të huaj. Shumë shpejt mori titullin e lartë Doktorë në mjekësi dhe në vitin 1973 krijoi Qendrën e Hematologjisë dhe Onkologjisë Pediatrike, në Spitalin Universitar të Gjenevës. Në këtë spital kanë kryer studimet e tyre universitare dhe pasuniversitare edhe shumë mjekë shqiptarë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut që sot kanë edhe titullin profesor në mjekësi. Sot kujtohet akoma me respekt nga ish-kolegët e tij në Spitalin Kantonal Universitar të Gjenevës, profesori i dëgjuar shqiptar, Isuf Kalo, i cili ka qene për një kohë të gjatë edhe funksionar i lartë i OMS-it në Koppenhagë. Kardiologjia Ardiana Keta, pas aftësisimit në Spitalin Kantonal Universitar të Gjenevës ka dhënë përvojën e saj, të fituar në Zvicër, por edhe në Francë, në Spitalin Kantonal të Lozanës, si dhe konsulentë në Spitalin me famë botërore të Zyrihut. Ajo tashmë ka hapur kabinetin e saj. Mjekë të tjerë nga Shqipëria dhe Kosova janë aftësuar në Spitalin Universitar të Gjenevës, dialektologe, dentistë, gjeneticienë e të tjera, si dhe një numër infermieresh që kanë marrë diploma në shkollën e Lartë « Bon Secours » në Gjenevë, partnere e privilegjuar e Spitalit Kantonal Universitar të Gjenevës. Roel

dhe Jorida Zoga së shpejti, përveç perfeksionimit në fushat e tyre të mjekësisë në Lion, për neurologji dhe laborator për talaseminë, do vijnë edhe në Gjenevë.

Doktoreshë Eÿss, ashtu si edhe profesor Jean-Philippe Assal që është njëkohësisht anëtar nderi i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe ka qene drejtor i një qendre të OBSH-së në Gjenevë, prof. Afksendyos Kalangos, kryekirurgu i famshëm botëror në Shërbimin e kardiologjisë vaskulare (ka realizuar me shumë sukses edhe operacione të zemrës të pacientëve shqiptarë dhe ka shpëtuar mese njëherë, jashtë territorit spitalor me

ishte më e mirë. Ajo iku ashtu e heshtur, me vështrim të pa tronditur në çastet e fundit, e urtë, pa u qarë njëherë. Ajo iku por qindra e qindra pacientë të saj, që tani janë në moshë madhore, zviceranë dhe të kombeve të tjerë që kanë zgjedhur Zvicrën si tokë qëndrimi, edhe për disa vite, do ta kujtojnë Doktoreshë Eÿssin, si një qenie të hijshme, të gjallë, me fytyrën që i shkëlqente para çdo pacienti. Personalisht, do të kujtoj ditët që kemi kaluar bashkë, jo vetëm kur ajo ushtronte profesionin e mjekes hematologe, por edhe kur ajo doli në pension. Kujtonim çastet e vështira por edhe gëzimin e saj kur pacienti bëhej më mirë ose shërohej fare, në sajë të teknikave të reja në mjekësi. Kujtonim pjesëmarrjen e saj në programe kërkimore për transplantimin e palcës së kockës tek fëmijët Talasemikë. Çdo herë që vija nga ndonjë udhëtim jashtë shtetit, nga konferencat ndërkombëtare për Talaseminë, më dëgjonte me vëmendje. Ashtu si ai profesori i nderuar shqiptar, Aleko Vesho që megjithëse kishte mbushur 80 vjet, i shprehej një mikut tim mjek që t'i dërgoj botime të reja për Talaseminë, edhe ajo ngaqë nuk kishte mundësi të lëvizte më, i priste si ujët e pakët botimet në përgjithësi për hematologjinë, por në veçanti për Talasemikët. Me mijëra faqe të shkruara nga dora e saj, nga përvoja e pasur e jetës mjekësore. Shumë nga to nuk i botoi, pasi nuk i quante si vlera të krijuara prej saj. E gjeta me lot në sy kur shfletoje së fundi revistën me prestigj « Amerikan Journal of Medical Genetics » ku ishte botuar një punë kërkimore e saj në fushën e hematologjisë. Kolegët nuk e harronin, por gjithmonë merrnin mendimin e saj, me gjithë moshën e thyer. Botimi i saj, së bashku me kolegun, docentin Pierre Eacker, « Regresi i insuficiencës kardiace pas administrimit ambulator intravenoz të Desferalit në Talaseminë Majorë » është një udhërrëfyes dhe një dëshmi e punës së saj me pasion, e ndjekjes me përsosmëri edhe të pacientëve shqiptarë. Kishte qene anëtare e Byrosë së Ligës kundër kancerit të Gjenevës, drejtuese e Departamentit të Pediatriisë në Qendrën Mjekësore Universitare të Vodit (CHUV), ku kanë punuar edhe punojnë akoma mjekë shqiptarë që kanë bërë emër në fushën e tyre të specialitetit mjekësor. Ka qene konsulentë e Spitalit të dëgjuar « La Tour » në Gjenevë, si dhe ka marrë pjesë në shumë programe kërkimore për transplantimin e palcës së kockës në Evropë.

Doktoreshë Eÿss, duke e parë pasionin tim për të mësuar më tepër për Talaseminë, më tha një ditë, pas leximit të dy librave të mi dy gjuhësh frëngjisht dhe shqip « Meditime për shqiptarët, Evropën dhe Kombet e Bashkuara », si dhe « Nxënësjja e etur e gjuhës romanësh », Toena, ku unë kam përfshirë përveç tregimeve, skicave dhe refleksioneve edhe artikuj të mi lidhur me hapat në luftën kundër Talasemisë : « Mesazhet lidhur me mjekim-

# Yuri Kim sworn in as US Ambassador to Albania: Reforms will be fully implemented and there will soon be EU membership

Yuri Kim has sworn in a few days ago as the US ambassador to Albania.

Ms. Kim was appointed by President Donald Trump in June this year. She said she will urge Albania's leaders to resolve the current political stalemate in order to strengthen the prospect of opening EU membership negotiations. Ms. Kim has also said she will encourage Albania to fully implement justice reforms. She has said she sees technical assistance to Albania as precedence in investigating, prosecuting and punishing corruption and transnational organized crime.

Ms. Kim is also expected to encourage Albania to achieve the 2 per cent level on defense spending by 2024.

Yuri Kim is the first Korean-American woman to represent the US in the post of an ambassador and the first person from the US territory of Guam to serve in such a post. She was born in Korea and raised on the Guam Island, a U.S. territory in the Pacific Ocean.



She has served in the State Department as the Director of the Office of Southern European Affairs, she was

the Director of the State Department's Center for the Study of Diplomacy, also as the Chief of the Staff for the

Deputy Secretary of State and Director of the Office for European Security and Political-Military Affairs.

## They are persecuted by parent who wants them to be monks, the drama of three youngsters who are rejected by the family

Denied by their parents for not accepting their father's submission to become monks. Not only that, but suffer their father's revenge days later when they returned to Albania after being deported from Ireland, where they have tried to build their lives as far away from the threat of their father that keeps stalking them.

This unusual story relates to two brothers Kosta and Niko Dinkallari, and their sister Nertila Dinkallari. Because of an arrangement their parent, forced by economic reasons, had made with a priest, the two brothers had to be locked up in a monastery to become monks. The conflict between the two brothers and their

father was not enough, but also the sister, Nertila Dinkallari had a sentimental relationship with a boy, with whom she became pregnant several months later. The Dinkallari brothers say that this unexpected flow on the family irritated the relationship between the parents and children. As if the refusal of the two brothers to be locked up in the monastery was not enough, their sister also started living together with a young man that belongs to a different religious faith. This was even more unacceptable for the parent of the three children, who began to treat them violently. When living with their family in the village of Porodina in Korça became unbearable, the Dinkallari brothers

and their sister were forced to emigrate.

They managed to settle in Ireland for a few days, but by the end of the previous year the two brothers were deported. They are on this situation because the Irish state did not consider their touching story.

As if this drama was not enough, when the two Dinkallari brothers returned to their homeland, they experienced that their father's revenge had become a shadow for them.

Constantly threatened with life and frightened by the persecution of their relative, the two brothers chose to settle in Tirana where they occupied a rented flat. They testify that in the early days of January they were suddenly attacked by masked men. There were three unknown people who were driven to retaliate, and hit with strong objects, as a result left one of the brothers severely injured. Niko Dinkallari was injured in the face, and was subsequently treated at the Trauma Hospital in Tirana.

While police are on the lookout for the perpetrators, for the two brothers eventually separated from the conflict with their father, the safety of life in Albania is at risk.

The Editorial Office



